



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 24. 2009

Prishtinë, më 29 qershor 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Kolë Berisha, Armend Zemaj dhe Selvije Halimi.

**Munguan:** Branislav Grbiq, ndërsa Ibrahim Makolli dhe Adem Hajdaraj e arsyetuan mospraninë e tyre.

**Të pranishëm:** Reshit Gashi – NDI, Lorik Bajrami – Çohu, dhe Isuf Zejna - KDI.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

**R e n d i i d i t ë s**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15 dhe të 22 qershorit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës të KQZ-së për vitin 2008,
5. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Riza Smaka për rishikimin e përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi,
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** - Pasi i përshëndeti të pranishmit, i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit, si dhe përfaqësuesin e shoqërisë civile. Propozoi të fillohet me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të punës të KQZ-së për vitin 2008.

**Adem Salihaj** - Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që nuk kemi pasur kohë ta lexojmë këtë raport, të cilin e kemi marrë me vonesë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara që Shqyrtimi i Raportit të punës të KQZ-së për vitin 2008, të shtyhet për mbledhjen e radhës. Komisioni vendosi që për mbledhjen e radhës të ftohet me shkresë edhe përfaqësuesi i KQZ-së.

## 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 15 dhe të 22 qershorit 2009

Kryetari - I pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje për procesverbalet.

*Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

**Kryetari** - I njoftoi anëtarët për komentet e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe shtoi se nëse konsiderojmë që janë me rëndësi, do t'i inkorporojmë. I ftoi anëtarët të shqyrtohet ky projektligj nen për nen, duke filluar nga neni 1 i këtij projektligji, se kush konsiderohet "*person i afërt me zyrtarin*". Iu referua edhe komenteve të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian.

**Bajram Kosumi** – Duke iu referuar formulimit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, "*Personat e afërt janë anëtarët e familjes së zyrtarit publik, familjarët e afërt, shokët dhe personat ose organizatat (p.sh., Personat fizikë dhe juridikë), me të cilët ai ose ajo ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose politike*" dhe shtoi se ky është formulim i drejtë vetëm se duhet të hiqet "apo politike".

**Adem Salihaj** – Tha se familja e ngushtë me zyrtarin do të ishte në rregull ta paraqesë pasurinë e tij, mirëpo konsideroi se edhe vëllezërit duhet të futen, sepse te ne nuk është rast i rrallë që pasuria të krijohet së bashku. Prandaj konsideroi se deklarimi i pasurisë edhe nga ana e vëllezërve duhet të shikohet si mundësi. Ndërsa kur të dalim jashtë prindërve, duhet të kihet kujdes, sepse rrethi zgjerohet shumë.

**Armend Zemaj** – Në diskutimin e tij shtoi se këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me deklarimin e pasurisë, por edhe me konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të zyrtarit publik. Parandej nëse dëshirojmë të bëjmë ligj të aplikueshëm nuk duhet të zgjerohet shumë ky

rreth, siç thuhet deri në shkallë të katërt, sepse ai formulim është marrë nga e drejta familjare e trashëgimore, kështu që nuk ma merr mendja se është formulim i drejtë.

**Selviqe Halimi – Vuri** në pah se gjatë amendamentimit të ligjit nuk mund të biem viktimë e disa veprimeve antiligjore, qoftë të funksionarëve publikë ose të luftohet nepotizmi me këtë ligj, por duhet të bëjmë ligj të zbatueshëm. Nëse dikush është pasuruar në mënyrë të paligjshme, nuk është e drejtë të kërkohet deklarimi i pasurisë edhe i personave të tjerë të afërm, sepse konsideroj se shkelet privatësia e tyre.

**Kryetari** - Përkufizimi “*person i besuar*” duhet të riformulohet “person i besueshëm” dhe është ai me të cilin ajo ose ai kishte ose ka marrëdhënie pasurie ose biznes me zyrtarin.

**Armend Zemaj – Për** nenin 2, paragrafi 2. 2, pika xvii e nenit 5 të Projektligjit plotësohet me fjalët “Guvernatori i Bankës Qendrore“, propozoi të shtohet edhe fjala “zëvendës-guvernatori”.

**Bajram Kosumi – Propozoi** që në nenin 2, paragrafi 2. xxiv të Projektligjit të shtohet në vazhdim edhe “ Të gjithë anëtarët e bordeve që emërohen nga Kuvendi dhe nga Qeveria”.

**Kryetari – Konstatoi** që paragrafët 10.3 dhe 10.4, të nenit 5, të hiqen, ndërsa nenet 7 dhe 9, mbetet të diskutohen në mbledhjen e radhës.

Pas diskutimit që u zhvillua Komisioni nxori këtë:

### **P e r f u n d i m**

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë Kundërkorrupsioni, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, si dhe të Zyrës së EULEX-it.

#### **5. Shqyrtimi i kërkesës se deputetit Riza Smaka për rishikimin e përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi**

**Kryetari-** Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

#### **6. Të ndryshme**

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës dhe vlerësoi se Ligji ka bazë juridike në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni

